

VENDIM
Nr. 381, datë 12.6.2014

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 35, DATË 29.1.2014,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË
PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME PËR VITIN 2014 NË NJËSITË
E QEVERISJES QENDRORE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 35, datë 29.1.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2014 në njësitë e qeverisjes qendrore është 765 veta, sipas lidhjeve nr. 1, nr. 2, nr. 3 dhe nr. 4, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.”.

b) Në lidhjen nr. 3, koha mesatare ditore e punës për punonjësin sanitar në aparatin e Ministrisë së Shëndetësisë bëhet 6 (gjashtë) orë në ditë, ndërsa periudha kohore e kontratës për punonjësit e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar bëhet “15 korrik 2014 deri më 15 dhjetor 2014”.

c) Pas lidhjes nr. 3, bashkëlidhur vendimit, shtohet lidhja nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi, ku detajohet ndarja e shtesës prej 9 punonjësish, të miratuar me këtë vendim.

2. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi përballohen nga shpenzimet korrente, të miratuara në buxhetin përkatës të institucioneve për vitin 2014.

3. Ngarkohen ministritë dhe institucionet buxhetore, sipas lidhjes nr. 4, bashkëlidhur këtij vendimi, të depozitojnë pranë Ministrisë së Financave detajimin e numrit të punonjësve brenda kritereve të përcaktuara në vendimin nr. 1703, datë 24.12.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe aktiviteteve sezonale/të përkohshme për ministritë dhe institucionet buxhetore.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

	Lidhja nr.4				
Gr	Emri i institucionit	Nr. i punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
3	Kryeministria	1			
	Departamentit Legjislacionit, Monitorimit të Programeve & Antikorrupsionit	1	Operatore/redaktor	8 orë/ditë	01.07.2014 -31.12.14
13	Ministria e Shëndetësisë	3			
	Qendra Kombëtare e Kontrollit të Gjaku	1	Receptioniste	8 orë/ditë	01.07.2014 -31.12.14
	Qendra Kombëtare e Kontrollit të Gjaku	2	Operatore	8 orë/ditë	01.07.2014 -31.12.14
4	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes	2			
	Qendra Kombëtare e Regjistrimit	1	arkivist -protokollist	8 orë/ditë	01.07.2014 -31.12.14
	Qendra Kombëtare e Regjistrimi	1	teknik	8 orë/ditë	01.07.2014 -31.12.15
	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile	2			
	Spektori i zhvillimit të programeve	1	specialist	8 orë/ditë	01.07.2014 -31.12.14
	Spektori i analizës financiare	1	specialist	8 orë/ditë	01.07.2014 -31.12.15
87	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	1			
	Drejtorja e Përgjithshme Detare	1	specialist kapitenerie	8 orë/ditë	15.06.14 -15.10.14
	Total punonjës me kontratë	9			